

**Prishtinë, 9 mars 2006**

**Nga:** **Dr. Nick Frydas**  
Kryesues Zyrës së Rregullatorit për Energji

**Për:** **Z. John Ashley**  
Drejtor menaxhues i KEK-ut

**Z. Agron Dida**  
Zëvendës ministër, MEM

**Kopje për:** **Dr. Joachim Ruecker**  
DSRSG- Shtylla IV, EU

**Z. Ekrem Belegu**  
Sekretar permanent, Ministria e Energjisë dhe Minierave

**Znj. Lejla Uzicanin**  
Këshilltare për Politikat Ekonomike, AKM

**Z. Ilir Salihu**  
Zyrtar ekzekutiv POEs, AKM

**Z. Sean Mc Goldrick**  
Drejtor ekzekutiv, KEK

**Z. Francois Pienaar**  
Drejtor për mbrojtjen e të ardhurave, KEK

**Dr. Ali Hamiti**  
Divizioni i Rregullatorit, KEK

**Znj. Sherife Avdyli**  
Divizioni i Rregullatorit, KEK

**Z. Ognjen Markoviq**  
Kryesues I Zyrës së Energjisë, AKM

**Kopje:** **Anëtarët e Bordit të ZRRE-së**

**Lënda:** **Raport final mbi Monitorimin e Politikave të Çkycjeve nga KEK-u**

## Monitorimi i Politikave të Çkyqjeve nga KEK-u.

Me datë 10.04.2005 Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka nxjerrë vendimin D\_02\_2005 mbi aprovimin e “**Procedurave të Çkyçjeve**” të KEK-ut dhe vendimin D\_03\_2005 mbi aprovimin e “**Procedurat dhe çmimet e shëbimit të çkyçjeve**”.

Në përputhje me nenin 54 c) të nenit të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, **Zyrës së Rregullatorit për Energji i jepet e drejta që të suhtrojë mbikëqyrjen në implementimin e akteve, vendimit dhe udhëzimeve.**

Prandaj, Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) brenda ZRRE-së ka ndërmarrë këto aktivitete:

- Në letërën e datës 21.12.2005 dërguar KEK-ut (kopje: MEM, UNMIK) ZRRE-ja ka kërkuar informacione dhe të dhëna për monitorimin e Politikës së Çkyçjeve.
- Me datë 12.01.2006, ZRREja ka mbajtur takim me stafin menaxhues të KEK-ut që është përgjegjës për Politikën e Çkyçjeve
- ZRRE-ja ka analizuar të dhënat e marra nga KEK-u, dhe i ka dorëzuar raportin e parë Bordit të ZRRE-së
- ZRRE-ja ka analizuar komentet e pranuar nga kryesuesi dhe anëtarët e Bordit të ZRRE-së, dhe
- Në fund të shkurtit I është dërguar një letër e dytë KEK-ut me kërkesë për të dhëna shtesë dhe shpjegime lidhur me disa të dhëna të marra nga ata.

Bazuar në të dhënat dhe informatat e pranuar, ZRRE-ja po dorëzon këtë raport final:

### 1. Numri i ekipeve të çkyqjes sipas distrikteve dhe nën-distrikteve

KEK-u ka paraqitur të dhënat për çkyçjet gjatë periudhës Qershor – Dhjetor 2005, përfshirë numrin e ekipeve të çkyqjes në secilin distrikt, të dhënat janë paraqitur në Tab.1 (Dhjetor 2005).

Prishtina	Prizren	Ferizaj	Gjilani	Peja	Mitrovica	Gjakova	<b>Total</b>
19	11	10	8	8	8	3	<b>67</b>

**Tab.1 (Nr. i ekipeve për çkyqje sipas distrikteve, Dhjetor 2005)**

- 1.1 Analizat e të dhënave të paraqitura dhe diskutimet me anëtarët e stafit të KEK-ut tregojnë se KEK-u ka vendosur sistemin për çkyçjen e konsumatorëve.
- 1.2 Sistemi, referuar sipas nenit 1.1 menaxhohet nga niveli qendror duke vijuar nëpër distrikte, në secilin distrikt është i emëruar menaxheri përgjegjës për procesin e çkyçjeve. Drejtori i Kontrollit të Pagesave i Divizionit të furnizimit udhëheq me këtë proces dhe ai shpjegoi procedurat dhe hapat që ndërmerren gjatë procesit të çkyqjes, gjithashtu ai shpjegoi edhe problemet që kanë gjatë implementimit të këtij procesi:
  - Numri i ekipeve për çkyqje nuk mjafton për ti përmbushur kërkesat
  - Caqet: 7 çkyqje/ditë në zona urbane dhe 5 në zona rurale. Nëse caqet nuk janë arritur ekipet e humbin bonusin, apo nëse rezultatet janë shumë të dobëta ata edhe mund të suspendohen (deri më tani vetëm dy ekipe nuk i kanë arritur caqet mujore)
  - Në 90% të rasteve caqet (numri i çkyqjeve për ditë) janë arritur nga ekipet për çkyqje (konstatim i KEK-ut)

- Të gjitha ekipet janë të pajisura me aparate digjitale, por ata kanë probleme logjistike (mungesë e automjeteve për transport)
- Për Prizren ka nevojë edhe për 8 ekipe shtesë
- Do të vendosen 4 ekipe për çkyqjen e konsumatorëve të jo-amvisnisë (konsumator me fuqi të madhe instaluese dhe me maxigraf të instaluar); këto ekipe do të jenë përgjegjëse për çkyqje në tërë Kosovën.

Rezultatet e prezentuara (koment i ZRRE) nuk dëshmojnë se ekipet i kanë arritur caqet; shih Tab.2

Prishtina	Prizren	Ferizaj	Gjilani	Peja	Mitrovica	Gjakova	Total
4.3	3.9	4.0	4.5	3.4	3.6	3.2	<b>3.8</b>

**Tab.2 (çkyqjet mesatare/ditë të realizura nga ekipet për çkyqje, Qershor – Dhjetor 2005)**

## 2. Numri i Vërejtjeve për Çkyqje të lëshara nga KEK-u

Në Tab.3 janë prezentuar të dhënat për numrin e vërejtjeve të lëshuara nga KEK-u (Qershor – Dhjetor 2005)

Prishtina	Prizreni	Ferizaji	Gjilani	Peja	Mitrovica	Gjakova	Total
27596	20597	14293	9350	11023	10782	6046	<b>109687</b>

**Tab.3 (Nr. total i Vërejtjeve për Çkyqje të lëshuara nga KEK-u (Qershor – Dhjetor 2005)**

Vërejtjet për çkyqje u janë shpërndarë konsumatorëve përmes anëtarëve të stafit të KEK-ut përgjegjës për leximin e njehsorëve, secili konsumator do të nënshkruajë se ka marrë (pranuar) vërejtjen për çkyqje. Për shkak të vështirësive në dorëzimin direkt të vërejtjeve, nganjëherë lexuesit e njehësorëve i lënë vërejtjet në pronat e konsumatorëve dhe nënshkruajnë në emër të konsumatorëve.

Borxhi total ka qenë rreth 137 milion euro për konsumatorët e paralajmëruar se do të çkyçen.

## 3. Numri total i konsumatorëve që kanë paguar borxhin apo që kanë nënshkruar kontratën KRB me KEK-un brenda afatit të paraparë në vërejtjen për çkyqje.

Numri total i konsumatorëve që kanë shmangur çkyqjen, pasi që kanë paguar borxhin ose kanë nënshkruar KRB në afatin e paraparë në vërejtje është paraqitur në Tab. 4.

Prishtina	Prizren	Ferizaj	Gjilani	Peja	Mitrovica	Gjakova	Total
5822	10573	1090	1629	2741	1539	1791	<b>25185</b>

**Tab.4 (Nr. total i konsumatorëve që kanë shmangur çkyqjen, në afatin e paraparë)**

Vetëm **22,9%** e konsumatorëve kanë shmangur çkyqjen në afatin e paraparë.

Vlera totale e borxhit paguar KEK-ut nga konsumatorët ka qenë **6,266,386 €**.

Kjo do të thotë se është miratuar që të paguhet 51.4 milion euro për vetëm 12% e kesaj shume është grumbulluar

ZRRE-ja nuk ka marrë informatë lidhur shumën e borxhit të caktuar që do të paguhet me KRB! KEK-u ka shpjeguar se kjo informatë mund të dorëzohet, por do të duhet kohë deri të mblidhen të gjitha informatat nga distriktet.

\*\*\*Në disa raste, konsumatorët (institucionet, kompanitë, etj.) i paguajnë borxhet e tyre përmes llogarisë bankare, kjo pagesë është bërë brenda afatit të paraparë në vërejtjen për çkyçje, por për shkak të shkëmbimit të varfër të informatave midis Divizionit të Financimit dhe atij të Furnizimit, kjo pagesë nuk është regjistruar në llogarinë e konsumatorit (ID) në KEK, dhe divizioni i furnizimit (i cili nuk ka marrë informatë se konsumatori ka paguar borxhin e tij) ndërmer masa dhe bën çkyçjen e konsumatorit.

Konsumatori është i ngarkuar me pagimin e çmimit të çkyçjes, dhe kjo shumë nuk është kompensuar më vonë nga KEK-u, edhe pse konsumatorët vërtetojnë se pagesa është bërë brenda afatit të paraparë.

**KEK-u do t'u shmanget këtyre rasteve (situatave), por nëse kjo ndodh; KEK-u do t'ia kompensojë çmimin e paguar të çkyçjes.**

#### **4. Numri i konsumatorëve që kanë sfiduar vërejtjen e marrë, duke dëshmuar se vërejtja ka qenë e lëshuar gabimisht për atë konsumator.**

Kanë qenë 82 ankesa nga konsumatorët lidhur me vërejtjet e dorëzuara për çkyçje, dhe 350 ankesa lidhur me mospranimin e vërejtjes për çkyçje. ZRRE-ja nuk ka marrë informatën mbi rastet e zgjidhura të ankesave të konsumatorëve.

#### **5. Numri i konsumatorëve të çkyqur nga KEK, duke aplikuar vendimin mbi Procedurat për Çkyqje**

Numri i konsumatorëve të çkyqur nga KEK-u, është paraqitur në Tab. 5 për periudhën Qershor - Dhjetor 2005.

Prishtina	Prizreni	Ferizaji	Gjilani	Peja	Mitrovica	Gjakova	Total
9696	6823	5955	4196	3849	3957	1790	<b>36266</b>

**Tab.5 (Nr. total i konsumatorëve të çkyqur nga KEK-u; Qershor - Dhjetor 2005)**

KEK-u ka çkyqur **33.063%** të numrit total të konsumatorëve që janë paralajmëruar me vërejtjen për çkyqje (Qershor - Dhjetor 2005).

KEK-u ka dhënë arsytet pse nuk janë çkyqur konsumatorët e paralajmëruar;

- Pushimet vjetore të të punësuarve, mungesa e mjeteve të transportit;
- Vërejtjet për çkyçje janë dhënë në përputhje me numrin e ekipeve për çkyçje, dhe duke u bazuar në parashikimet për numrin e konsumatorëve që pritet të paguajnë borxhin brenda afatit të paraparë në vërejtjen për çkyçje. Ky parashikim ka qenë më I ulët se që është pritur dhe kjo ka qenë arsyeja pse ata nuk kanë arritur të çkyçin të gjithë konsumatorët e paralajmëruar.

KEK-u nuk ka arritur të sigurojë informata mbi numrin total të borxhit të konsumatorëve, të çkyqur nga KEK-u.

KEK-u është justifikuar se do të nevojitet kohë për grumbullimin e këtyre të dhënave.

## 6. Kategoritë e konsumatorëve të çkyqur në % - sipas distrikteve dhe në total

	Prishtina	Prizren	Ferizaj	Gjilani	Peja	Mitrovica	Gjakova	Total
Amvisni (%)	67.41	61.87	28.71	51.24	49.29	70.08	39.57	<b>52.59</b>
Jo-amvisni (%)	32.59	38.13	71.29	48.76	50.71	29.92	60.43	<b>47.41</b>

**Tab.6 (Kategoritë e konsumatorëve të çkyqur në %)**

## 7. Numri i konsumatorëve të rikyqur pasi arsyet e çkyqjes janë eliminuar

Numri total i konsumatorëve të rikyqur pasi arsyet e çkyqjes janë eliminuar është paraqitur në Tab. 7

Prishtina	Prizren	Ferizaj	Gjilani	Peja	Mitrovica	Gjakova	Total
4087	2642	1355	1667	1300	1320	494	<b>12865</b>

**Tab.7 (Nr. total i konsumatorëve të rikyqur pasi arsyet për çkyqje janë eliminuar; Qershor – Dhjetor)**

Pas çkyqjes nga KEK-u, vetëm **35.47%** e konsumatorëve ka qenë të rikyqur në mënyrë legale nga KEK-u. Të tjerët janë rikyqur ilegalisht apo janë ende pa furnizim?

KEK-u ka raportuar se konsumatorët e rikyqur ilegalisht janë çkyqur për herë të dytë, dhe ata janë rikyqur sërish; Kontrolluesit e KEK-ut ishin duke përgatitur rastin për në gjyq.

KEK-u nuk kishte arritur të sigurojë informacion mbi shumën totale të borxhit të paguar nga konsumatorët e rikyqur; justifikimi: ata kanë nevojë për më shumë kohë për mbledhjen e kësaj informate.

## 8. Numri i konsumatorëve të kyqur apo të rikyqur pa autorizim me shkrim nga KEK-u.

Numri total i konsumatorëve të kyqur apo të rikyqur pa autorizim me shkrim nga KEK-u është paraqitur në Tab. 8

Prishtina	Prizren	Ferizaj	Gjilani	Peja	Mitrovica	Gjakova	Total
1552	995	1077	901	230	193	46	<b>5040</b>

**Tab.8 (Nr. total i konsumatorëve të kyqur/rikyqur ilegalisht; Qershor – December 2005)**

Ekipet kontrolluese të KEK-ut kanë zbuluar se vetëm **13.89%** të konsumatorëve janë kyqur ilegalisht pas çkyqjes së tyre nga KEK-u. KEK-u nuk ka informatë për 17,193 konsumatorët e kyqur në mënyrë ilegale.

## 9. Numri i konsumatorëve që mbeten ende të çkyqur

Numri total i konsumatorëve që mbeten ende të çkyqur (Dhjetor 2005) është paraqitur në Tab. 9.

Prishtina	Prizren	Ferizaj	Gjilani	Peja	Mitrovica	Gjakova	Total
142		72	278	440		245	<b>1177</b>

**Tab.9 (Nr. total i konsumatorëve që mbeten ende të çkyqur (Dhjetor 2005)**

KEK nuk posedon me të dhëna të besueshme për numrin e konsumatorëve të cilët janë pa furnizim me energji si pasojë e çkyqjeve nga KEK-u.

#### 10. Numri i pagesave (denimeve) të paguara në KEK në pajtim me Kapitullin 2 të Vendimit D\_02\_2005 për kyqje të paautorizuar apo rikyqje.

KEK-u ka prezentuar tek ne shumat e faturuara të vërejtjeve për çkyqje si dhe shumat e faturuara të pagesave për çkyqje të paraqitura në Tab. 10.

	Prishtina	Prizren	Ferizaj	Gjilani	Peja	Mitrovica	Gjakova	Total
Vërejtja për çkyq. (€)	265,604	191,084	139,290	107,524	126,794	105,133	56,879	<b>992,308</b>
Denime (€)	848,987	509,795	372,152	274,082	239,572	170,335	113,218	<b>2,528,101</b>

**Tab. 10 (Vërejtjet dhe denimet e faturuara)**

KEK-u ka faturuar **3.5 Mil. EURO** (Korrik – Dhjetor 2005) tek konsumatorët në emër të vërejtjeve për çkyqje dhe ngarkesave për çkyqje dhe rikyqje.

KEK-u nuk arriti të na informojë:  
Sa ka qenë shuma totale e mbledhur? Ose  
Sa është borxhi nga këto ngarkesa?

#### 11. Regjistri i pagesave në emër të denimeve dhe penaltive në kontot e KEK-ut.

Aktualisht KEK-u nuk ka mundësi të ndajë pagesën për energjinë e konsumuar nga pagesa për dënime dhe ngarkesa; secili konsumator ngarkohet në faturën e tij/saj me: konsumin, tatimin për TV, vërejtjen për çkyqje, pagesën për çkyqje/rkyqje etj, dhe kur konsumatori paguan një pjesë të borgjit apo nënshkruan KRB nuk mund të parashikohet se cila pjesë e borgjit është paguar apo riprogramuar.

Në njoftimet e tyre shpjeguese, KEK-u nuk paraqet ndonjë sqarim lidhur me këtë çështje

#### 12. Numri i rasteve kur KEK-u aplikon Nenin 10.2 të vendimit D\_02\_2005 (Heqja e paisjeve për furnizim të konsumatorit për shkak të përsëritjes së akteve të dhunës nga ana e konsumatorit).

Numri total i rasteve kur është aplikuar/implementuar nga ana e KEK-ut Neni 10.2 i Vendimit D\_02\_2005, është paraqitur në Tab.11.

Prishtina	Prizren	Ferizaj	Gjilani	Peja	Mitrovica	Gjakova	Total
1304	886	0	0	230	315	46	<b>2781</b>

**Tab.11 (Nr. total i konsumatorëve ku janë hequr paisjet për furnizim; Qer.-Dhjet.2005)**

#### 13. Çfarë mënyra të çkyqjes janë përdorur (Mënjanimi i siguresave, çkyqja në njehsorët elektrikë, heqja e kabllit furnizues, apo tjetër formë)

Metodat vijuese janë përdor për çkyqjen e konsumatorëve:

- Çkyqje në njuhësor elektrik
- Çkyqje në shtyllë elektrike
- Heqje e kabllit furnizues

#### 14. Numri i rasteve të proceduara në gjyq, dhe numri i rasteve të zgjidhura nga gjyqi.

Numri total i rasteve të proceduara në gjyq dhe numri i rasteve të zgjidhura nga gjyqi është paraqitur në Tab.12

	Prishtina	Prizren	Ferizaj	Gjilani	Peja	Mitrovica	Gjakova	Total
Proceduara	492	241	158	150	111	193	16	<b>1361</b>
Zgjidhura	0	0	7	0	0	0	0	<b>7</b>

**Tab.12 (Numri i rasteve të proceduara në gjyq, dhe numri i rasteve të zgjidhura nga gjyqi; Qer.-Dhjet. 2005)**

Prej **1361** rasteve të proceduara në gjyq vetëm **7** raste janë zgjidhur nga Gjyqi dhe ato vetëm në Distriktin e Ferizajit

Rezultatet e rasteve të zgjidhura në gjyq pritet të dorëzohen nga KEK-u në një të ardhme të afërt.

*Raporti i shkruar më lart është bazuar në të dhënat e siguruar nga divizioni i furnizimit të KEK-ut.*

*Më poshtë është raporti i bazuar në të dhënat e siguruar nga divizioni i Rrjetit të KEK-ut*

#### 15. Data dhe koha e leximit të njehsorëve në nënstacionet 110/10kv, 110/35kv dhe 35/10 për secilën periudhë të marrëveshjes dhe daljet

Në nënstacionet 110/10kv, 110/35kv dhe nënstacionet 35/10kv leximi është kryer në ditën e parë të muajit, në ora 8:00 paradite.

#### 16. Numri i daljeve të njehsorëve në nënstacionet me mundësi të regjistrimit automatik (memorizim) të vlerave të energjisë/data.

Ekzistojnë 137 njehsorë digjitalë të furnizimit të instaluar në nënstacione.

#### 17. Programi kohor i leximit të njehsorëve të konsumatorëve;

Lexuesit e Rrjetit të Distribuimit i lexojnë njehsorët prej datës **1 deri 5** të çdo muaji.

#### 18. Numri i furnizuesve nëpër nënstacione pa njehsorë – sipas distriktit dhe në total

	Prishtina	Prizreni	Ferizaji	Gjilani	Peja	Mitrovica	Gjakova	TS 110/10 kv	Total
Nr. I daljeve (10) pa njehsor	96	21	8	6	14	0	23	23	<b>191</b>

**Numri i daljeve pa njehsor (Tab. 13)**

## **19. Numri i nënstacioneve me furnizim alternativ në rrjetin e ingranum**

Të 531 nënstacionet (10/04kv) kanë mundësinë e furnizimit alternativ.

## **20. Numri i konsumatorëve që kanë mundësi teknike të ndërrimit të daljeve**

Ekzistojnë mundësitë teknike për 72364 konsumatorë për të ndërruar daljet e furnizimit.

## **21. Kopjet e të gjitha dokumenteve përfshirë raportet, letrat e punës, memorandumet dhe të dhëna që shprejtojnë proceset e bashkërendimit.**

Divizioni i furnizimit i KEK-ut paraqiti para DMK të ZRRE-së gjithë dokumentacionet lidhur me procedurat e çkyçjes, duke treguar dokumentacionin e radhitur për secilin konsumator të çkyçur. Të dhënat janë regjistruar në formë elektronike dhe secili rast ka dosjen e vet, ku të gjitha masat e ndërmarra nga KEK-u janë regjistruar dhe radhitur në dosje.

## **Konkludim**

Për të përmirësuar Politikën e vet të Çkyçjeve, KEK-u duhet të ndërmarrë këto masa:

- Të sigurojë një plan veprimi për ZRRE-në për aktivitetet prioritare që lidhen me politikën e çkyçjeve. Ky plan veprimi të dorëzohet në ZRRE brenda një muaji nga dita e pranimit të këtij raporti. Secila detyrë e planit të veprimit të diskutohet me ZRRE-në dhe të vendosen të arriturat reale dhe programi i implementimit.
- Të bëjë përpjekje dhe të informojë ZRRE-në mbi aktivitetet për instalimin e njehsorëve nëpër nënstacione/ në të gjithë daljet dhe te konsumatorët
- Të bëjë të qartë ndarjen e të hyrave nga taksat, detyrimet, penaltitë dhe pagesat nga të hyrat nga detyrimet e energjisë së konsumuar. Ato duhet të jenë të regjistruara në kategori të ardhurash të ndryshme. KEK-u do të sigurojë për ZRRE-në një plan për menaxhmin e kësaj çështjeje brenda një muaji nga dita e pranimit të këtij raporti.
- Të marrë masa në përmirësimin e politikës së çkyçjeve në pajtim me Rregullën mbi Çkyçjen dhe Rikycjen e konsumatorit që zëvendëson vendimin D\_02\_2005.

Në shtesë të aktiviteteve të përmendura më lart, KEK-u ka nevojë që të vazhdojë implementimin e politikës së çkyçjes me përqëndrim më të madh në:

- Sigurimin se konsumatorët kanë marrë vërejtjen për çkyçje, para procedimit të procedurës për çkyçje
- Përmirësimin e fushatës së informimit (njoftimit) me politikën e çkyçjeve (KEK)
- Informimin e konsumatorëve për të drejtat dhe obligimet e tyre
- Informimin e konsumatorëve për pasojat dhe gjobat që ata duhet t'i paguajnë nëse ata janë çkyçur.
- Përmirësimin e efikasitetit të ekipeve të themeluara për çkyçje
- Rritjen e numrit të stafit për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve

- Bashkëpunimin me komunat dhe qeverinë lokale, dhe kërkimin e përkrahjes së tyre
- Kontrollimin dhe monitorimin e ekipeve për çkyçje; marrjen e masave disiplinore ndaj ekipeve që nuk kanë arritur të implementojnë politikën (shkarkimin e ekipeve të korruptuara)
- Rritjen e numrit të ekipeve për çkyçje në të gjitha distriktet
- Sigurimin e ndohmës logjistike për ekipet e çkyçjes (automjete, pajisje për çkyçje, makinë me ngritës)

Politika e çkyçjeve e KEK-ut kërkon përkrahje edhe nga:

- Konsumatorët
- PISG (gjykatat, ministritë, ZRRE-ja, komunat)
- Donatorët, UNMIK-u